



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.235, datë 02.07.2020

PËR

VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATJA ZNJ. {...} TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË GJYKATËN E LARTË, PËR DY POZICIONE TË LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 85 DHE NR. 86, DATË 26.02.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE TË KANDIDIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 02.07.2020, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatës znj. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr. 85, datë 26.02.2020, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

2. Në këtë rast afati i kandidimit është përcaktuar “*dy javë nga dita e publikimit i vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor*”.

3. Me Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, Këshilli ka vendosur:

“I. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

4. Në këtë rast afati i kandidimit është përcaktuar “*dy muaj nga dita e publikimit i vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor*”.

5. Vendimet e Këshillit si më lart janë publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit më datë 28.02.2020, duke filluar të ecin afatet e kandidimit nga dita e nesërme, pra nga data 29.02.2020.

6. Afatet e kandidimit për ngritjen në detyrë, përfshirë dhe në Gjykatën e Lartë, u pezulluan nga Këshilli më datë 12.03.2020, për shkak të situatës së krijuar në vend nga përhapja e Covid-19, ndërkohë që me Vendimin e tij nr. 142, datë 22.04.2020, këto afate u zgjatën edhe për një periudhë tjetër të caktuar. Konkretisht, për pozicionin e para të lirë, në fushë të së drejtës civile, afati i kandidimit u zgjat me një javë, duke përfunduar ai më datë 29.04.2020. Ndërsa për pozicionin e dytë të lirë sërisht në fushën e së drejtës civile, afati i kandidimit u zgjat me një muaj, duke përfunduar ai më datë 26.05.2020.

7. Brenda afatit të kandidimit, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin nr. 85, datë 26.02.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, ka kandiduar edhe gjyqtarja znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja), aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së {...}

8. Me Vendimin nr. 151, datë 06.05.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me Vendim nr. 85, datë 26.02.2020”, Këshilli ka vendosur:

“I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr.85, datë 26.02.2020 (në fushën e të drejtës civile), të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ...9.Për kandidaten znj. {...}-relator z. Alban Toro; ...”.

9. Ndërkohë, kandidatja aplikoi brenda afatit të kandidimit edhe për pozicionin e dytë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 86, datë 26.02.2020. Nisur nga kjo, në

rastin e Vendimit nr.201, datë 11.06.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, mbështetur në pikën 7, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli ka vendosur se procedura e verifikimit për kandidaten znj. {...}, filluar me Vendimin e tij nr. 151, datë 06.05.2020, është e vlefshme edhe për kandidimin e saj për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020.

10. Më datë 07.05.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

11. Brenda afatit të përcaktuar kandidatja nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

12. Më datë 12.05.2020, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidates iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

13. Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa një nga dokumentet, pikërisht formularin e deklaratës së pasurisë, sipas Vendimit 75/2019, kandidatja duhet ta dorëzonte, jo më vonë se 21 ditë nga dita e dërgimit të tij, pra deri më datë 02.06.2020, pranë ILDKPKI-së. Kjo e fundit nuk e ka njoftuar Këshillin, sikundër i është kërkuar, në rastin e mos përmbushjes së këtij detyrimi nga ana e kandidates, çka nënkupton dorëzimin nga kandidatja të formularit të deklaratës së pasurisë.

14. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 19.05.2020, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Lartë, ndër ta edhe për kandidaten znj. {...}. Për këto kritere ligjore kandidimi procedura e verifikimit është në proces e sipër.

15. Sipas pikës 9, të Vendimeve të Këshillit nr.85, dhe nr.86, datë 26.02.2020, është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”*. Ndërkohë në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimeve të Këshillit nr.85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë përcaktohen ..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës civile, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*. Nga ana tjetër, në shkronja “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtyre dy vendimeve, përcaktohet se: *“c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

16. Në respektim të vendimeve si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kriterëve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidaten znj. {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykatat ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtares.

16.1 Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me Shkresën nr.2148/1 prot., datë 18.05.2020, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

16.2 Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht nën kriterit të “përvojës specifike profesionale” të kandidates në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës civile, referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtares, konkretisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, më pas në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë ku me pas është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Gjyqtarja znj. {...} është emëruar në Gjykatën {...}. Informacioni iu kërkua vetëm Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, ndërsa është e qartë përvoja e kandidates në Gjykatën {...}. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor {...} informacioni i kërkuar është përcjellë me Shkresën nr. 2240/1 prot., datë 14.05.2020, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...} informacioni i kërkuar është përcjell me Shkresën nr. 2240 prot., datë 14.05.2020, informacioni i kërkuar është përcjell me Shkresën nr.

2240/2 prot., datë 14.05.2020 dhe për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR TRE KRITERET E KANDIDIMIT

17. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.

18. “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 85, datë 26.02.2020, është parashikuar si kusht kandidimi në nenin 136, pika 3 (fjalë e parë), të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se: *“Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit”*. Ndërkohë, “përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë parashikohet dhe në nenin neni 47, pika 5, të Ligjit për Statusin. Sipas kësaj dispozite, ky kriter kandidimi përbëhet në vetvete nga dy të tillë, ai për “përvojën e përgjithshme profesionale minimale” dhe ai për “përvojën specifike profesionale minimale”. Konkretisht në këtë dispozitë të ligjit përcaktohet se: *“Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë Gjykatës së Lartë ..., nëse ka ushtruar funksionin **jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”***.

19. Për verifikimin e kandidates në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë u mbajt parasysh se ajo ka kandiduar për dy pozicione të lira, ato në fushën e të drejtës civile, çka do të thotë se kandidatja, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, që është e njëjtë për të dy kandidimet, pra jo më pak se **trembëdhjetë vjet**, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra **jo më pak se pesë vjet** në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, konkretisht në fushën e të drejtës civile për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020.

20. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se me vendim nr.13 ajo ka punuar si ndihmës/gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës gjatë periudhës nëntor 1993- tetor 1998, kohë kur ka filluar studimet në Shkollën e Magjistraturës. Evidentohet se ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2001 dhe është emëruar në shtator 2000 për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}, ku ka ushtruar funksionin deri në tetor 2001, kohë kur është emëruar si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}, ku ka ushtruar funksionin deri në tetor 2003, kohë kur është transferuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}ku ka ushtruar funksionin deri në prill 2004. Në prill 2004 është emëruar si gjyqtare pranë Gjykatës së {...} deri në dhjetor 2019. Znj {...} nga dhjetori 2019 është emëruar në mënyrë të përhershme pranë Gjykatës {...} ku vijon të ushtrojë funksionin e gjyqtares.

21. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja {...}, **me vendim nr.13 datë 24.11.1993 deri më datë 1.10.1998 ka ushtuar funksionin e ndihmës gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.** Me Dekretin nr.2742 datë. 15.09.2000 është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Më pas me Dekretin nr.3111 datë 02.10.2001 të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}. Me pas me vendit të KLD së nr.147/1 datë 11.10.2003 është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}. Me dekret nr. 4194 datë. 05.04.2004 të Presidentit të Republikës është emëruar gjyqtare e Gjykatës së {...}. Së fundmi me Vendimin nr. 289 datë 18.12.2019 të KLGJ është emëruar në mënyrë të përhershme pranë {...} ku vijon dhe sot ushtrimin e funksionit të gjyqtares.

22. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 85 dhe nr. 86 datë 26.02.2020, ka mbi njëzet e katër vjet përvojë të përgjithshme profesionale, si gjyqtare në gjykatën e shkallës së parë dhe të shkallës së dytë, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës profesionale minimale”.

23. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor {...} me shkresë nr.1285 datë 20.05.2020, rezulton se:

“Gjyqtarja {...} fillimin e detyrës së gjyqtarit e ka ushtruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, prej datës 15.09.2000 deri vitin 2001.

Gjatë kësaj periudhe ajo ka gjykuar më së shumti çështje të karakterit civil dhe pak penal, vendime të cilat janë përcjell nga gjykata e cila ndër të tjera shprehet se nuk disponon urdhra për ndarje në dhoma / seksione të gjyqtareve.

24. Referuar të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor {...}, rezulton se kandidatja znj. {...} ka gjykuar çështje civile dhe penale gjatë viteve të stazhit profesional 2000 dhe 2001. Konkretisht, duke filluar nga shtatori i vitit 2000 deri në tetori 2001, kandidatja ka gjykuar 6 çështje në lëndë penale dhe 37 çështje në lëndë civile.

25. Sipas informacionit të ri kërkuar më datë 08.06.2020 nga ana e Relatorit si dhe nga dokumentacioni i përcjell nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor {...} me shkresë nr.1506 datë 15.06.2020, rezulton se: “Referuar të dhënave statistikore për periudhën Janar 1994- Shtator 1998 për gjyqtaren znj. {...} kohë gjatë së cilës ka ushtruar funksionin e ndihmës gjyqtares nga Volumet e Vendimeve të arkivës janë përcjellë këto të dhëna: *duke filluar nga janari deri në*

dhjetor 1994 kandidatja ka gjykuar 171 çështje në lëndë civile, për periudhën shkurt deri në dhjetor 1994 ka gjykuar 15 çështje në lëndë penale; duke filluar nga tetori deri në dhjetor 1995, kandidatja ka gjykuar 13 çështje në lëndë civile, për periudhën 1 -31 dhjetor 1995 ka gjykuar 3 çështje në lëndë penale; duke filluar nga janari deri në dhjetor 1996, kandidatja ka gjykuar 301 çështje në lëndë civile, për periudhën janar -dhjetor 1996 ka gjykuar 7 çështje në lëndë penale; duke filluar nga janari deri në dhjetor 1997 kandidatja ka gjykuar 196 çështje në lëndë civile, për periudhën 1- 31 prill 1997 ka gjykuar 1 çështje në lëndë penale; duke filluar nga janari deri në shtator 1998 kandidatja ka gjykuar 164 çështje në lëndë civile, për periudhën 1 -31mars 1998 ka gjykuar 1 çështje në lëndë penale.”

26. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor {...} me shkresë nr.130 datë 15.05.2020, rezulton se:

“Gjyqtarja {...} ka ushtruar funksionin e gjyqtares pranë kësaj gjykate, prej datës 08.10.2001 deri në vitin 30.10.2003.

1. Në periudhën 10.10.2002, ka qenë pjesë e trupës gjyqësore, Dhoma Civile (Vendim nr. 490 prot., datë 10.10.2002).

27. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor {...} me shkresë nr. 2554/1 datë 18.05.2020, rezulton se:

“Gjyqtarja {...} ka ushtruar funksionin e gjyqtares pranë kësaj gjykate, prej datës 22.10.2003 deri në vitin 06.04.2004.

Gjatë kësaj periudhe ajo ka gjykuar më së shumti çështje të karakterit civil vendime të cilat janë përcjell nga gjykata e cila ndër të tjera shprehet se nuk disponon urdhra për ndarje në dhoma / seksione të gjyqtareve

28. Referuar të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor {...}, rezulton se kandidatja znj. {...} ka gjykuar çështje civile dhe penale gjatë viteve 2003 dhe 2004. Konkretisht, duke filluar nga tetori i vitit 2003 deri në prill 2004, kandidatja ka gjykuar 3 çështje në lëndë penale dhe 95 çështje në lëndë civile.

29. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 85 dhe nr. 86 datë 26.02.2020, ka përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile, si

gjqtare e shkallës së parë, 3 vjet e 6 muaj e 21 ditë, si dhe si ndihmësgjyqtare¹ për 4 vjet e 8 muaj, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës specifike profesionale minimale”.

29.1 Këshilli diskutoi lidhur me atë nëse përvoja e kandidatit si ndihmësgjyqtar duhet të konsiderohet si përvojë profesionale në kuptim të pikës 5, të nenit 47, të Ligjit për Statusin, duke arritur në përfundimin se kjo përvojë llogaritet në përvojën e përgjithshme dhe atë specifike profesionale që kërkon kjo dispozitë ligjore për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë. Për këtë, Këshilli mbajti në konsideratë se e drejta ekskluzive e gjykatave për dhënien e drejtësisë realizohet përmes dhënies së vendimeve në çështje të caktuara, vendime këto që për një kategori çështjesh, për periudhën deri në vitin 2001, referuar legjislacionit të kohës për organizimin e pushtetit gjyqësor dhe kodeve të procedurave gjyqësore (civile/penale), janë dhënë nga trupa gjykues të përbërë nga një gjyqtar dhe dy ndihmësgjyqtarë. Pra, në këtë periudhë, pavarësisht ekzistencës në gjykatat e shkallës së parë të pozicioneve të gjyqtarit dhe të ndihmësgjyqtarit, funksioni i tyre ka qenë i njëjtë, ai i dhënies së drejtësisë në çështje të caktuara. Në këtë pikëpamje gjyqtari dhe ndihmësgjyqtari kanë ushtruar të njëjtin funksion. Përveç kësaj, fillimisht, sipas ligjit të kohës, gjyqtari dhe ndihmësgjyqtari kanë pasur të njëjta kushte emërimi dhe organ emërtese, të njëjtën përgjegjësi disiplinore dhe penale, të njëjtën mbrojtje nga ligji penal, sikundër edhe të njëjtat të drejta dhe detyrime, me përjashtim të nivelit të pagës. Më pas, si kontingjent i mundshëm për t'u emëruar gjyqtar, vetë ligji², krahas ish-gjyqtarëve, ka përcaktuar dhe ndihmësgjyqtarët, duke barazuar përvojën profesionale të tyre dhe vendosur një kufi minimal të njëjtë përvoja, kufi të cilin më pas e ka hequr për ndihmësgjyqtarët në detyrë. Nga ana tjetër, deri më sot, për efekt të karrierës gjyqësore dhe të trajtimit financiar të gjyqtarëve, përvoja profesionale si ndihmësgjyqtare është konsideruar përvojë profesionale si gjyqtare. Një gjë e tillë ka ndodhur edhe për kandidaten në rastin konkret, prandaj një interpretim dhe zbatim i ndryshëm do të rrezikonte të çonte në cenimin e sigurisë juridike për të.

29.2 Lidhur me përvojën specifike profesionale minimale të përshtatshme për pozicionet e lira ku kandidatja ka kandiduar (në fushën e së drejtës civile), Këshilli vlerësoi se kandidatja plotëson këtë kriter ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Lartë pavarësisht faktit se kjo përvojë daton përpara vitit 2004. Për këtë Këshilli mbajti në konsideratë se ligji nuk kufizon në kohë pasjen nga kandidatja të përvojës profesionale minimale të përshtatshme për pozicionin e lirë. Nëse qëllimi i ligjvënësit do të kishte qenë i ndryshëm, pra qenien koherente të një përvoja të tillë (brenda një periudhe të kufizuar kohore nga momenti i kandidimit), atëherë ai do ta kishte përcaktuar këtë sikundër ka vepruar për procedura të tjera në lidhje me zhvillimin e karrierës gjyqësore. Nga ana tjetër, Këshilli vlerësoi se, në mungesë të një autorizimi për të nga ligji, ai nuk mund të vendoste kufijë kohorë të përvojës profesionale minimale të përshtatshme për pozicionin e lirë që kërkohet nga pika 5, e nenit 47, të Ligjit për Statusin. Përveç kësaj, edhe momenti në të cilin gjendet

¹ Ligji nr. 7574, date 24.06.1992 “Për Organizimin e Drejtësisë dhe disa ndryshime ne Kodin e Procedurës Penale e Civile me ndryshime.

² Ligji nr. 8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 20, pika 3.

procedura e ngritjes në detyrë në rastin konkret, nuk mund të përlijte vendosjen rishtazi të rregullave që shkojnë në dëm të disa prej kandidatëve.

30. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

31. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Lartë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 85 dhe nr.86, datë 26.02.2020, është parashikuar në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.*

32. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 10.03.2020, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.*

33. Sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

34. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

35. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

36. Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Lartë, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5 të Vendimeve të Këshillit nr. 85 dhe nr.86, datë 26.02.2020, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”.* Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”.* Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëria ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme:*

a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”.

37. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 10.03.2020, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësish ligjore, ka deklaruar se: “Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

38. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë.

39. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, duke plotësuar kështu kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.

III. KONKLUZIONE

40. Referuar kërkesave të Vendimit 75/2019, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimeve nr. 85, nr. 86, datë 26.02.2020, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit të znj. {...}, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

41. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit për kandidaten znj. {...}, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj nga kandidimi në lidhje me këto kriterë. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, të tre kriterëve të sipërpërmendura të kandidimit dhe vijim e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 85 dhe nr.86, datë 26.02.2020.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si dhe në pikën 9, të Vendimeve të tij nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 85 dhe nr.86, datë 26.02.2020.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR